



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. Prot.
Nr. Dok. 202100801/2

Tiranë ___/___/2021

Lënda: Rekomandohet përmirësimi i kushteve dhe i trajtimit të viktimave të mundshme të trafikimit në Qendrën Kombëtare Pritëse të Viktimave të Trafikut, Linzë.

Drejtuar: Znj. Suela ASLLANI
Drejtor
Qendra Kombëtare Pritëse e Viktimave të Trafikut, Linzë.

TIRANË

Për dijëni: Znj. Luneda SUFALI
Drejtor i Përgjithëshme
Shërbimit Social Shtetëror
Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

TIRANË

Për dijëni : Znj. Erjeta ALHYSA
Drejtor i Zyrës Vendore Arsimore Tiranë.

TIRANË

Të nderuar,

Avokati i Popullit, në rolin e Mekanizmit Kombëtar për Parandalimin e Torturës, Trajtimin ose dënimit të egër, çnjerëzor ose poshtëruës, në vijim Mekanizmi Kombëtar (MKPT), seksion pranë Avokatit të Popullit, bazuar në nenin 19/1, të ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999, "Për Avokatin e Popullit", i ndryshuar, më datë 28.05.2021 kreu një inspektim në Qendrën Kombëtare Pritëse të Viktimave të Trafikut në vijim (QKPVT) Linzë, sipas një Plani Vjetor Inspektimi të miratuar nga Avokati i Popullit. Në përbërje të grupit inspektues ishin znj. Gloria Çarkaxhiu dhe znj. Nertila Qafzezi me detyrë Nd/komisionerë pranë Mekanizmit Kombëtar.

Objektivi kryesor i kësaj vizite monitoruese ishte vlerësimi i kushteve të QKPVT Linzë, cilësia, mënyra e trajtimit të personave brenda saj, si dhe masat e marra për zbatimin e rekomandimeve të Avokatit të Popullit, të bëra gjatë inspektimeve të mëparshme.

Grupi i inspektimit u takua me drejtuesen e Qendrës znj. Suela Asllani, të cilës i shpjegoi qëllimin dhe metodologjinë e inspektimit. Nga ana e drejtueses të institucionit, ekspertëve të grupit inspektues iu ofrua mundësia që të kishin akses brenda rregullave dhe pa vështirësi në të gjithë personat dhe ambientet që duhet të monitoronin.

Pasi u njoh me konstatimet e grupit inspektues, Avokati i Popullit ka detyrimin kushtetues dhe ligjor t'ju parashtrorj konkluzionet përfundimtare, duke ju referuar si më poshtë:

Shënime paraprake

Inspektimi u krye në përputhje me procedurën e monitorimit të ndjekura deri tani nga Mekanizmi Kombëtar. QKPVT është pjesë përbërëse e rrjetit të institucioneve të përkujdesit shoqëror të administruara nga shërbimi social shtetëror. Kjo Qendër ka si mision përmirësimin e statusit social të viktimave të mundshme të trafikimit, ndërgjegjësimin dhe aftësimin e tyre për jetesë të pavarur në komunitet, nëpërmjet zhvillimit të vazhdueshëm të procesit të vetëvlerësimit, të luftës së stigmës ndaj kësaj kategorie dhe diskriminimit që kanë efekt të drejtpërdrejtë në riintegrimin e plotë. Qëllimi i kësaj Qendre është rehabilitimi i grave e vajzave të trafikuar ose të identifikuar si potencial trafikimi. QKPVT u ofron përfituesve një vendqëndrim të përkohshëm të sigurt, jashtë rrezikut, duke ofruar në të njëjtën kohë, ndihmë të specializuar për riaftësimin dhe rikthimin në jetën normale.

QKPVT është pjesë përbërëse e institucioneve të Përkujdesit Shoqëror të administruara nga Shërbimi Social Shtetëror. Veprimtaria e këtij institucioni është bazuar në politikat e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale. QKPVT është krijuar dhe zhvillon veprimtarinë e saj në zbatim të VKM-së nr. 589, datë 28.08.2003, “Për ngritjen dhe vënien në funksionim të Qendrës Kombëtare Pritëse të Viktimave të Trafikimit”, ligjit nr. 9355, datë 10 03.2005, “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore” dhe akteve nënligjore në zbatim të tij, VKM nr. 658, datë 17.10.2005n “Për standardet e shërbime shoqërore”, VKM nr.195, datë 11.04.2007, “Për miratimin e standardeve të shërbimeve të përkujdesit shoqëror në qendrat rezidenciale, për personat e trafikuar ose në rrezik trafikimi” në Konventën për të Drejtat e Njeriut, si dhe në Strategjinë Sektoriale të Mbrojtjes Sociale. Qëllimi i kësaj qendre është rehabilitimi i grave, vajzave dhe fëmijëve të trafikuar, ose të identifikuar si potencial trafikimi.

Qendra Kombëtare Pritëse e Viktimave të Trafikimit ka këto objektiva kryesore:

1. Përmirësimi dhe zhvillimi i jetës dhe gjendjes social-psikologjike, ekonomike, kulturore etj., të viktimave të trafikimit apo rrezik trafikimi, nëpërmjet shërbimeve sociale, psikologjike, juridike, mjekësore, arsimore, sigurisë për jetën, kualifikime profesionale, argëtuese etj., që zhvillohen në Qendër.
2. Ofrimi i paketës së ndihmës, duke rritur nivelin e cilësisë dhe së shërbimeve, aktiviteteve bashkëkohore në përputhje me misionin dhe standardet kombëtare të punës për viktimat e trafikimit në qendrat rezidenciale.
3. Zbatimi dhe implementimi me përpikmëri i detyrave dhe akteve ligjore dhe nënligjore që dalin në kuadër të zbatimit të Strategjisë së luftës kundër trafikimit të qenieve njerëzore.
4. Kooperimi dhe rritja e bashkërendimit të veprimeve me institucionet shtetërore, organizatat dhe OJQ-të, të huaja dhe vendase, që punojnë në fushën e luftës kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore.
5. Rritja e bashkëpunimit me familjen për të realizuar kthimin e viktimave në familje, në rastet kur është e mundur, në kuadër të deinstiucionalizimit të shërbimeve.
6. Rritja e bashkëpunimit me pushtetin vendor për realizimin sa më të mirë të procesit të monitorimit për riintegrimin e viktimave të trafikimit në familje apo në komunitet.

7. Forcimi i bashkëpunimit me Koalicionin Kombëtar të Strehëzave Antitrafik për kombinimin e shërbimeve ofruar viktimave të trafikimit për arritjen e rehabilitimit dhe riintegrimin sa më të mirë dhe të shpejtë të tyre.

8. Dhënia e ndihmës viktimave të mundshme të trafikimit për të zhvilluar një ndjenjë kontrolli mbi jetën e tyre dhe për të kuptuar gjendjen e tyre aktuale dhe atë që kanë kaluar, si dhe për të shkuar drejt një ndryshimi konstruktiv.

Shërbimet që ofron Qendra Kombëtare Pritëse e Viktimave të Trafikimit.

QKVT realizon shërbime dhe ndihmë për viktimat e trafikimit dhe viktimat e mundshme të trafikimit duke ofruar: ushqim, veshje, strehim të përkohshëm, nivel të lartë sigurie, asistencë psiko-sociale, asistencë të specializuar psikologjike, asistencë mjekësore, asistencë ligjore, edukim arsimor, zhvillimi i potencialeve nëpërmjet trajnimeve dhe kualifikime profesionale, aktivitete rehabilituese dhe riintegruese, referim për riintegrim, përgatitje për riintegrim në familje, bashkëpunim me aktorë të tjerë për monitorim dhe vlerësim i viktimave të mundshme të trafikimit gjatë procesit të riintegrimin.

QKVT përbëhet nga dy godina (një godinë dy katëshe dhe një godinë tre katëshe) me kapacitet akomodues prej 80 shtretërish gjithsej. Aktualisht në funksionim janë vetëm 10 shtretër të vendosur në godinën dy katëshe, ku është e vendosur edhe administrata e Qendrës. Godina tre katëshe është jashtë funksioni, pasi është shembur pas dëmeve të konsiderueshme të shkaktuara që nga tërmeti i nëntorit, dhe momentalisht ndodhet në fazën e projektimit. Në këto kushte kapaciteti akomodues është vetëm 10 persona dhe në Qendër në momentin e inspektimit ndodheshin 5 gra të strehuara përfituese.

Rastet e trajtuara nga periudha janar 2020 deri qershor 2021 janë:

Viti 2020 në qendër janë asistuar **10 raste: 7 raste** te mbartura nga 2019, **3 raste** të reja në 2020:

- **viktima trafikimi** janë identifikuar **4 raste**
- **viktima të mundshme trafikimi** janë identifikuar **6 raste**
- **minorene** të akomoduar në qendër **5 raste**
- **maxhorene** të akomoduar në qendër **5 raste**
- **Shtetase të huaja** të akomoduar në qendër **2 raste**, J.T (Gambia, Afrika VMT) rasti është referuar tek të “Ndryshëm dhe të Barabartë”, J.S (Serbia, identifikuar si VT) është realizuar riatëdhësimi në bashkëpunim me IOM.

Viti 2021 janë akomoduar në qendër **9 raste: 5 raste** të mbartura nga 2020, **4 raste** te reja në 2021:

- **Viktima trafikimi** janë identifikuar **5 raste**
- **Viktima të mundshme trafikimi** **4 raste**
- **Minorene** të akomoduar në qendër **4 raste**
- **Maxhorene** të akomoduar në qendër **5 raste**
- **Shtetase të huaja** të akomoduar në qendër **3 raste** (CH.V, shtetase Italiane, identifikuar VMT), (I.M dhe A.N shtetase Rumene identifikuar si VT, në bashkëpunim me Ambasadën është realizuar riatëdhësimi i tyre).

Riintegrimi i tyre është realizuar përmes:

Viti 2020

- Referimit në organizata partnere “Të ndryshëm dhe të barabartë”: 1 rast;
- Referimit në familjet biologjike: 4 raste;
- Riatdhesim në vendin e origjinës 1 rast.

Viti 2021

- Riatdhesim në vendin e origjinës 2 raste;
- Referim në familjen biologjike 2 raste.

Gjatë vitit 2021 janë regjistruar pranë Zyrave të Punës dhe ndjekin kurset profesionale pranë Qendrës së Formimit Profesional nr. 4 si më poshtë:

- Kursi i modelimit/3 përfituese
- Kursi i parukerisë/1 përfituese

Gjatë vitit 2021 në bashkëpunim me shkollën “*Lidhja e Prizrenit*” ndjekin arsimin e detyrueshëm me kohë të pjesshme: 2 përfituese

Nga informacioni i grumbulluar në vend, kryerja e intervistave me stafin e institucionit, si dhe këqyrja e dokumenteve, objekteve, pajisjeve dhe mjediseve, rezultoi se rekomandimet e institucionit të Avokatit të Popullit ndonëse janë pranuar në parim, vetëm një pjesë e tyre janë zbatuar.

Rekomandimet e paraqitura nga Avokati i Popullit që nuk kanë gjetur zbatim dhe nuk ishin plotësuar, janë si vijon:

- Marrjen e masave për rikonstruksionin e pjesshëm të godinës 2 katëshe, pasi ambientet e saj kanë pësuar dëme të konsiderueshme dhe janë të pasigurta ambientet e banimit në të.
- Marrjen e masave për përfundimin sa më shpejt të rikonstruksionit të godinës tre katëshe brenda Qendrës.
- Marrjen e masave për pajisjen e institucionit me një automjet për garantimin e ofrimit të shërbimeve për përfitueset jashtë Qendrës.

Rekomandim i përsëritur i Avokatit të Popullit për garantimin e procesit mësimor për arsimin e detyrueshëm 9-vjeçar ka gjetur zbatim dhe momentalisht 2-përfituese të Qendrës ndjekin vitin shkollor online me kohë të pjesshme në shkollën “*Lidhja e Prizrenit*”.

Trajtimi

Grupi i inspektimit kishte si objektiv të punës së tij mbledhjen e informacionit lidhur me trajtimin e përfitueseve të strehuara në Qendër, në identifikimin e rasteve të përdorimit të forcës fizike apo të presionit psikologjik ndaj kësaj kategorie. Nga informacioni i marrë, grupi inspektues nuk konstatoi ndonjë rast torture trajtimi të papërshtatshëm apo përdorimi të tepruar të forcës fizike.

Numri i personelit në këtë qendër është **17 punonjës**, nga të cilët **5 punonjës social**, **1 mjeke**, **1 psikolog**, **1 edukator** dhe **1 kujdestare**. Mungonte vetëm 1 punonjës social, vakanca e të cilit ishte krijuar në muajin maj dhe pritej zëvendësimi i tij në kohë sa më të shpejtë. Asistenca psiko-sociale realizohet dhe përmbushet përmes shërbimit dhe

raporteve psiko-sociale nga personeli i specializuar. Punonjësit social të cilët kanë edhe rolin më të madh në këtë qendër kryenin vlerësimin e nevojave të identifikuara dhe hartojnë programe të ndërhyrjes, këshillimin individual dhe në grup për mbrojtjen e interesave individuale të përfitueseve. Aktivitetet për përfitueset synonin organizimin e punës në grup dhe bashkëpunim çka rriste ndjeshëm dhe cilësinë e shërbimit ndaj tyre.

Qendra pritëse ka realizuar shërbimet si më poshtë:

- Asistencë dhe intervistim të viktimave të trafikimit, potencial për trafikim apo të dyshuara si të tilla, pranë drejtorisë së Policisë Tiranë, si dhe Komisariate Tiranë.
- Lidhur me shërbimet mjekësore, juridike, psikologjike janë lidhur kontrata bashkëpunimi me drejtorinë e QSUT-së, ISHP-së, klinikën “Ufo Dental”, institucione të cilat kanë ofruar bashkëpunim në dhënien e ndihmës për viktimat e trafikimit.
- Lidhur me ri-integrimin e viktimave është vepruar në bazë të referimit pranë organizatave të shoqërisë civile.
- Për të gjitha viktimat e trafikut që kanë shprehur vullnetin dhe dëshirën e tyre për të filluar një jetë të pavarur larg familjes është mundësuar referimi dhe ri-integrimi i tyre pranë organizatave “Vatra Vlorë”, “Të ndryshëm dhe të barabartë”, në Tiranë.

Mbi marrjen e masave për parandalimin e infeksionit të shkaktuar nga Covid-19

Në kuadër të masave parandaluese për përhapjen e virusit Covid-19 si dhe në vijim të akteve ligjore të miratuara për këtë qëllim ishin marrë masa konkrete. Aktualisht në Qendër janë të akomoduar 5 përfituese dhe gjendja shëndetësore e tyre paraqitet e mirë. QKPVT me rastin e pandemisë globale të shkaktuar nga Covid-19, në institucion ishin marrë masa të menjëhershme për pajisjen me dezinfektantë si dhe pajisjen me maska dhe doreza personale për përfitueset dhe stafin. Ishin afishuar në të gjithë vendet e dukshme rregulla të ndryshme për parandalim dhe mbrojtjen ndaj Covid-19.

Asistenca mjekësore përmbushej nga mjekja e Qendrës e cila realizonte vlerësimin e nevojave mjekësore të përfitueseve në momentin e akomodimit në Qendër. Në bashkëpunim me shërbimet shëndetësore rajonale plotësonte dosjen mjekësore të përfitueseve dhe hap kartelat shëndetësore për to. Ilaçet sigurohen përmes blerjeve të vogla, sipas nevojave specifike të personave që trajtohen në këtë qendër. Në rastet emergjente shëndetësore mjeku ndjek dhe shoqëron trajtimin e tyre në spital apo tek specialisti.

Gjatë inspektimit në QKPVT, nuk u paraqitën ankesa lidhur me trajtimin, ushqimin apo për probleme dhe shqetësime të tjera. Koha e qëndrimit të personave në këtë Qendër varionte nga 3 muaj deri në një vit. Sipas procedurës, grupi ndërdisiplinor trajton çdo rast specifik deri në përfundimin e gjykimit dhe integritit të viktimës së mundshme të trafikimit.

Masat mbrojtëse

Nga intervistimet e bëra nga grupi i inspektimit rezultoi se të gjithë personat e akomoduar në Qendrën Kombëtare Pritëse të Viktimave të Trafikut ndodheshin aty si viktimat të mundshme të trafikimit. Një rëndësi të veçantë përgjatë inspektimit kishte dhe shpërndarja e informacionit nga ana e stafit të Qendrës drejt përfitueseve në lidhje me shërbimet që ofrohen dhe të drejtat dhe detyrimet e tyre.

Për të garantuar sigurinë e jetës së banorëve, që trajtoheshin në Qendrën Kombëtare Pritëse e Viktimave të Trafikut, ishte instaluar dhe funksiononte një sistem monitorimi me kamera, si për ambientet e jashtme ashtu dhe për ato të brendshme. Siguria e Qendrës mbështetej nga forcat policore të Ministrisë së Brendshme, në kuadër të marrëveshjes së nënshkruar me Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit e cila është përgjegjëse direkte për sigurinë brenda dhe jashtë perimetrit të Qendrës me mbulim 24-orë. Mbrojtja e përfituesve mbështetej në evidentimin dhe plotësimin e nevojave të veçanta, bazuar në vlerësimin e gjithë jetës së përfituesve, aspekteve emocionale, fizike, arsimore, sociale, gjinore, etj.

Sistemi i ankesë/kërkesave funksiononte konform akteve normative në fuqi. Ankesat e banorëve depozitoheshin në një kuti të posaçme, e cila hapej një herë në muaj nga punonjësit e Shërbimit Social Shtetëror. Në rastet kur ankesat kishin karakter urgjent, ankueset takoheshin drejtpërdrejtë me drejtuesin e institucionit.

Për përfitueset ishin hartuar dosjet e tyre personale të cilat përmbajnë:

- Proces-verbal i akomodimit i nënshkruar nga tre palët pjesëmarrëse në procesin e intervistimit dhe identifikimit në organet referuese (kryesisht policia e shtetit).
- Intervista paraprake,
- Deklaratë akomodimi,
- Intervistë e kompletuar me të dhënat lidhur me procesin e trafikimit të përfitueses.
- Vlerësimi i nevojave të përfitueses nga ekipi multidisiplinar.
- Plani i ndihmës, i cili përfshin të gjitha aktivitetet dhe shërbimet që janë parashikuar të realizohen për plotësimin e nevojave, të identifikuar nga specialistët e fushës: Akomodimi afat-gjatë, kualifikimi profesional, mbështetja juridike, mbështetja mjekësore, mbështetja arsimore brenda Qendrës.
- Plani i rehabilitimit për çdo përfituese.
- Rezultatet mujore të këshillimit nga psikologu dhe punonjësi social.
- Raport i shërbimeve të ofruara dhe rezultatet e arritura gjatë kohës së qëndrimit.
- Takimet me familjarët në relacion për çdo të tillë.
- Aktivitete pjesëmarrëse në to.

Vizitat me të afërmit realizohen dhe monitorohen pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit për siguri të lartë të përfitueseve në qendër. Punonjësi që kishte në ndjekje rastin mbante kontaktet me të afërmit e viktimës së mundshme të trafikimit. Prej periudhës mars 2020 e deri në maj 2021 për shkak të situatës së krijuar nga pandemia Covid-19 ishin ndaluar takimet me familjarët për shmangien e përhapjes së virusit. Ndërkohë që me lehtësimin e masave që prej majit 2021 kishin filluar të lejoheshin takimet me familjarët në ambientet e Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë duke respektuar të gjitha masat anti-covid.

Në kuadër të ndërtimit të një sistemi për monitorimin e standardeve, grupi inspektues u informua se pas daljes nga Qendra, personat e akomoduar në të, ktheheshin në familjet e tyre ose në strehëzat e ngritura nga OJF të ndryshme, të cilat i ndihmojnë në procesin e riintegritimit të tyre dhe sistemimit në jetën e përditshme.

Gjatë monitorimit në mesin dy katëshe, grupi i inspektimit konstatoi se ishin afishuar postera, jo vetëm për të drejtat e përfitueseve, por edhe të drejtat dhe detyrimet e personelit të punësuar pranë Qendrës, pjesë kjo e rregullores së brendshme të Qendrës.

Kushtet materiale

Në këtë qendër e cila është e përbërë nga dy godina, ndonëse ishin bërë rikonstruksione të pjesshme të ambienteve të jashtme dhe të brendshme të saj, prej tërmetit të nëntorit 2019, godina tre katëshe kishte dalë jashtë funksionit dhe për këtë arsye ishte shembur dhe ende ndodhej në fazë projektimi. Aktualisht përfitueset ishin të akomoduar në katin e parë të mesin dy katëshe e përshtatur për banim, ku ndodhej dhe pjesa e administratës së institucionit. Kjo godinë ka një rrjet të amortizuar elektrik, kishte dëmtime të konsiderueshme, dhe ka nevojë emergjente për rikonstruksion të pjesshëm të saj. Kushtet higjienike ishin të mira por ambientet ishin të pamjaftueshme pasi hapësira ishte e kufizuar.

Gjatë vizitës së vitit të kaluar na ishte bërë me dije nga Drejtuesja e institucionit se ishte parashikuar rindërtimi i plotë i mesin tre katëshe dhe se ishte përgatitur një projekt i detajuar duke siguruar fondet e nevojshme nga implementimi i një projekti të USAID. Ky projekt nuk kishte përfunduar dhe konkretisht godina tre katëshe e banimit nuk ishte rikonstruktuar por për shkak të dëmtimeve të rënda që kishte pësuar ishte shembur dhe deri në ditën e inspektimit nuk kishte filluar akoma rindërtimi i saj por projekti ndodhej në fazën e projektimit pasi ishin bërë matjet e nevojshme.

Rrethimi i jashtëm i Qendrës si pasojë e tërmetit kishte pësuar rrëshqitje, dhe paraqiste probleme pasigurie dhe paqëndrueshmërie.

Tualetet ishin përgjithësisht të mirëmbajtura, me kushte të mira higjieno-sanitare ishin siguruar panelet diellore kishin ujë të ngrohtë për larje gjatë gjithë kohës. Produktet higjieno-sanitare dhe ishin siguruar veshmbathjet e përshtatshme për përfitueset e të gjitha moshave dhe masave. Ndërkohë ishin në funksion makinat larëse dhe shërbimet e tjera sanitare.

Furnizimi me ujë të pijshëm ishte në 24 orë, si dhe ishte zgjidhur çështja e ndërprerjeve të energjisë elektrike, pasi institucioni ishte pajisur me gjenerator. Sistemi qendror i ngrohjes ishte funksional si dhe sigurohej rregullisht sipas parashikimeve të rregullores së brendshme të institucionit.

Kuzhina, megjithëse e pajisur me mjetet e domosdoshme, vazhdonte të kishte probleme lagështire, si rezultat i amortizimit të ndërtesës. Ushqimi ishte i larmishëm dhe i bollshëm, kampionet ushqimore emërtoheshin sipas vakteve ditore, ato ruheshin në kushte frigoriferike. Mensa ishte një mjedis brenda kësaj godine me rreth 8 tavolina ngrënieje në kushte të mira higjienike.

Dhoma e mjekes ishte e rregullt dhe e pajisur me një krevat vizitash, një dollap për mbajtjen e medikamenteve dhe një tjetër për mbajtjen e kartelave mjekësore për secilën përfituese. Grupi i inspektimit konstatoi se ishte bërë një rikonstruktim i këndit të lodrave për fëmijë.

Përgjatë inspektimit u evidentua gjendja tejet e amortizuar e automjetit të institucionit, i cili ishte i vetmi mjet i cili mbulonte të gjitha shërbimet jashtë institucionit për nevojat e përfitueseve.

Aktivitetet

Stafi i sektorit psiko-social ishte i përbërë nga **5** punonjës social dhe një psikologe. Ky staf, përveç aktiviteteve rehabilituese, planeve ndihmëse dhe konsultave individuale sipas rasteve, plotësonte dosjet me të dhënat personale të përfituesve dhe i administronte ato. Punonjësit socialë mbi bazën e vlerësimit të nevojave hartonin programe të ndryshme për të bërë të mundur integrimin e përfitueseve në jetën sociale, nëpërmjet organizimit të aktiviteteve dhe sinkronizimit të ndërhyrjeve.

Rehabilitimi për përfitueset kryhej me programe shërbim/ këshillimi, individual ose në grup. Punonjësit socialë shoqëronin përfitueset në takimet me familjarët dhe kurset profesionale. Psikologja në qendër hartonte skeda psikologjike lidhur me llojin e terapisë që përdorej, lojëra dhe aktivitete për zhvillimin psikologjik. Në bazë të nevojave individuale psikologu i shoqëronte përfitueset në seancat gjyqësore. Qendra kishte edhe një bashkëpunim të mirë organizuar me qendrat; “Të ndryshëm dhe të barabartë”, Tiranë; “Tjetër Vizion”, Elbasan dhe “Vatra” në Vlorë, të cilat së bashku përbënin Koalicionin Kombëtar Antitrafik.

Kurset e formimit profesional në QKPVT ofroheshin nga Qendra e Formimit Profesional nr. 4, Tiranë, ku disa përfitueseve i ofrohej mundësia për kurse parukerie, kuzhine, rrobaqepëseje, etj. Për këtë qëllim ishte vënë në dispozicion edhe baza materiale.

Edhe përgjatë vitit 2021 viktimat e trafikimit të akomoduar pranë Qendrës janë të regjistruara 4 përfituese në kurse profesionale.

Sa i përket arsimimit 9-vjeçar për viktimat që strehoheshin në këtë qendër, grupi i inspektimit u informua, se 2 përfituese janë regjistruar dhe kanë ndjekur rregullisht këto orë mësimi online brenda Qendrës për vitin shkollor 2020-2021 në shkollën “*Lidhja e Prizrenit*”.

Stafi i sektorit psiko-social e kishte plotësuar rregullisht dhe me rigorozitet dokumentacionin duke përfshirë vlerësimi i nevojave të përfitueseve, planet ndihmëse, konsultat individuale, e deri në integrimin e tyre me mbështetjen edhe të shoqatave apo qendrave që trajtojnë këtë kategori personash.

Aktivitetet me natyrë relaksuese, argëtuese, okupacionale, zhvilluese, ndërgjegjësuese si dhe aktivitetet me natyrë njohëse të vlerave kulturore dhe historike, me natyrë festive të miratuara sipas një Kalendari Aktivitetesh të miratuar nga Drejtori i QKPVT.

Shërbimi shëndetësor

Organika e Qendrës ishte e plotësuar me një mjekë me kohë të plotë. Mjeku në momentin e mbërritjes së përfitueseve në Qendër kryente vlerësimin e nevojave mjekësore. Në bashkëpunim me shërbimet shëndetësore rajonale, kryente plotësimin e dosjes personale mjekësore të përfitueseve dhe hapte kartelat shëndetësore. Vizitat kryheshin në dhomën e mjekes dhe medikamentet, përfshirë këtu edhe ato të urgjencës, ndodheshin në një dollap të posaçëm. Për sa i përket rasteve për të cilat nevojitej konsultë e specializuar, shërbimi ofrohej pa vonesa nga mjekë specialistë të QSU “Nënë Tereza” Tiranë.

Herë pas here në këtë institucion nevojitej edhe një vlerësim i specializuar i psikiatrit për shkak të specifikave dhe problemeve që mund të manifestoheshin nga përfitueset gjatë trajtimit në këtë qendër. Ky shërbim mund të ofrohej nga Qendra Komunitare e Shëndetit Mendor, e cila i përket zonës së mbulimit të këtij institucioni.

Medikamentet siguroheshin nëpërmjet një buxhetit të veçantë të Qendrës. Shërbimi stomatologjik kryhej rregullisht nga një subjekt privat, bazuar në marrëveshjen që kjo qendër kishte lidhur me klinikën përkatëse.

Institucioni nuk kishte një autoambulancë, në raste emergjente, përdorej makina e Qendrës për transportimin e përfitueseve pranë qendrave spitalore.

Nga këqyrja e dokumentacionit që administronte mjekja e këtij institucioni, u konstatua se ekzistonte një regjistër vizitash, si dhe kartelat për secilën përfituese të cilat ishin të plotësuara me rregull.

Për sa më sipër dhe në mbështetje të pikës 3, të nenit, 63 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë ku thuhet se: *“Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga administrata publike”* dhe të nenit 21, germa “b” të ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999 *“Për Avokatin e Popullit”*, i ndryshuar, ku thuhet se: *“Avokati i Popullit paraqet rekomandime për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ, që, sipas tij ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive”*,

REKOMANDOJMË:

1. Marrjen e masave për përfundimin sa më shpejt të projektimit dhe rindërtimit të godinës tre katëshe brenda Qendrës e cila është shembur që në tetor 2019.
2. Marrjen e masave për rikonstruksionin e pjesshëm të godinës dy katëshe, pasi ambientet e saj kanë pësuar dëme të konsiderueshme dhe janë të pasigurta për banim.
3. Marrjen e masave për pajisjen e institucionit me një automjet për garantimin e ofrimit të shërbimeve për përfitueset jashtë Qendrës.
4. Marrjen e masave për garantimin e vijimit të procesit mësimor online për arsimin e detyrueshëm 9-vjeçar pasi që, duke ju referuar tipologjisë së shërbimeve në QKPVT është e nevojshme të realizohet ofrimi i mësimdhënies së detyrueshme brenda

ambienteve të institucionit, duke pasur në konsideratë nivelin e lartë të rrezikshmërisë ndaj këtyre personave.

5. Marrjen e masave për plotësimin e menjëhershëm të organikës me një punonjës social.

Për qëndrimin dhe masat që do të merrni në zbatim të këtij rekomandimi, të vihemi në dijeni brenda afatit 30 ditor sipas nenit 22 të ligjit nr. 8454 dt. 04.02.1999 “*Për Avokatin e Popullit*”, i ndryshuar.

Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj.

KOMISIONERE

ERMONELA XHAFA

Punoi: G.Çarkaxhiu
N.Qafzezi